



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:189826  
Datë: 26.01.2024  
Numri i dokumentit: 05248381

Ac.nr.3655/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit paditësit G.T nga fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës, i cili përfaqësohet sipas autorizimit nga Atdhe Dika, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Fushë Kosovës me seli në Fushë Kosovë, e cila përfaqësohet nga e autorizuar H.Q, avokate publike komunale, për shkak të shpërblimit të dëmit, me vlerë të kontestit 2,794.56 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1589/2011, i datës 03.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.01.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Fushë Kosovës me seli në Fushë Kosovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1589/2011, i datës 03.03.2021, VËRTETOHET

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1589/2011, i datës 03.03.2021, ka vendosur si në vijim:

*I.APROVOHET kërkesëpadia e paditësit G.T nga fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës.*  
*II.DETYROHET e paditura Komuna e Fushë Kosovës me seli në Fushë Kosovë, që në emër të shpërblimit të dëmit material, si rezultat i aksidentit të komunikacionit të ndodhur me datë 15.06.2011, ku është dëmtuar automjeti i paditësit i markës “Golf IV” 1.9 TDI, me targa të regjistrimit 01-953-CC, paditësit G.T t’ia kompensoj shumën prej 2,794.56 € (me fjalë: dy mijë*

*e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër euro e pesëdhjetë e gjashtë cent), me kamatë vjetore si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë (datë: 13.07.2011), e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit ligjor.*

*III.DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj paditësit shumën prej 706.50 € (me fjalë: shtatë qind e gjashtë euro e pesëdhjetë cent), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit ligjor. Refuzohet kërkesa për pagesën e shpenzimeve procedurale përtej shumës së gjykuar, dhe atë në emër të përfaqësimit në seanca gjyqësore në shumën prej 167.50 €.”*

Kundër këtij aktgjykimi e autorizuar e të paditurës në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Apelit ta refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ose të prishet aktgjykimi dhe lënda të kthehet në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit së tij, me datë 13.07.2011, në gjykatën e shkallës së parë, fillimisht ka paraqitur padi fillimisht duke e paditur, Hekurudhat e Kosovës, me seli në Fushë Kosovë dhe XH.C, nga fshati ..., Komuna Podujevë, punëtor i Hekurudhave të Kosovës, vozitës i Lokomotivës. Ndërsa me parashtrësën e datës 31.07.2017, ka bërë precizimin e padisë duke e paraqitur si të paditur vetëm Komuna e Fushë Kosovës në Fushë Kosovë, e të cilën e ka precizuar në seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilën kanë kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit për kompensimin e dëmit material, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1589/2011, i datës 03.03.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se vlerëson se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko-detyrimor, pasi që aksidenti i komunikacionit nga i cili rrjedhë kërkesa për dëmshpërblim ka ndodhur me datë 15.06.2011. Duke vlerësuar pretendimet e palëve, gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara, gjykata ju referua nenit 154 paragrafi 1 i Ligjit mbi Detyrimet. Në bazë të lartcekurave gjykata ka vërtetuar se e paditura është përgjegjëse ndaj këtu paditësit konform përgjegjësisë në bazë të fajësisë, të parashikuar me dispozitat e nenit 178 paragrafi 1 i Ligjit mbi Detyrimet (i vitit 1978)

dhe dispozitave mbi shpërblimin e dëmit konform shkallës së përgjegjësisë së tyre për dëmin material të shkaktuar. Lidhur me bazën e përgjegjësisë të të paditurës Komuna e Fushë Kosovës, nga gjendja faktike e vërtetuar, Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e paditura mbanë përgjegjësinë e pjesëshe për shkak të kontributit të dhënë në dëmin e shkaktar – pjesërisht për faktin se të njëjtët nuk kanë vendosur shenjat përkatëse të komunikacionit, mbi bazën e të cilave do të udhëhiqet lëvizja e automjeteve në rrugë. Tutje ka theksuar se përgjegjësia e të paditurës është përcaktuar me nenin 25 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 02/L-70 mbi sigurinë e komunikacionit rrugor. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se vlerëson se e paditura ka pasur për detyrë si organ komunal të vendos shenjat e komunikacionit në përputhje me LSKRR. Rrjedhimisht, mos veprimi i të paditurës ka rezultuar në aksident të komunikacionit në rastin konkret.

Lartësinë e shumës së gjykuar për dëmin material në automjetin e paditësit, gjykata e ka përcaktuar duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të makinerisë Ing. S.B, të cilit ia fali besimin plotësisht, pasi që i njëjti vlerësimin e lartësisë së dëmit të bërë në bazë të kritereve profesionale duke marrë për bazë vlerës të automjetit së dëmtuar në treg, në kohën e ndodhjes së aksidentit, duke e vlerësuar atë në vlerë prej 6,816.00 €, nga e cila shumë ka hequr vlerën e pjesëve të mbetura nga dëmi total në automjet në shumën prej 1,226.88 €, dhe si përfundim ka përcaktuar lartësinë e kompensimit në shumën prej 5,589.12 €. Vlerësimi i tij ishte në përputhje edhe me foto dokumentacionin, raportin policor dhe prova të tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Tutje në arsyetim theksohet se Gjykata vëren se eksperti në ekspertizën e makinerisë, kishte bërë përlllogaritjen sa i përket rregullimit të automjetit pas aksidentit, e e cila arrin vlerën prej 6.950.00 €. Mirëpo duke qenë se riparimi i automjetit teknikisht dhe ekonomikisht nuk është i arsyeshëm, përkatësisht kemi të bëjmë me dëm total në automjetin në fjalë, vlera e dëmit është llogaritur sikurse në paragrafin e mësipërm, duke përfshirë edhe përgjegjësinë e ndarë të palëve ndërgjyqëse, gjykata ka vendosur të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit në lartësinë e përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Andaj, mbi bazën e nenit 189 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, në përputhje me mendimin e ekspertit, gjykata e aprovoi kërkesën për dëm material, në shumën prej 2,794.56 €, si në dispozitiv. Kjo shumë përbën 50% nga shuma e kompensimit që sipas vlerësimit të ekspertit (5,589.12 €) do t'i takonte paditësit në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar në automjetin e tij.

Vendimi për kamatën është marrë konform nenit 277 të LMD-së. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 i LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë në shkelje tjera për të cilat pretendojnë të paditurat, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të palës së paditur në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vlerëson se këto pretendime nuk janë të

themelta, pasi që nuk ka qenë kontestuese se ka ndodhur aksidenti i komunikacionit me datës 15.06.2011 rreth orës 15:45 në fshatin Nakaradë Komuna Fushë Kosovë, ashtu që deri tek aksidenti ka ardhur pasi që vetura të cilën ishte duke e drejtuar paditësi ishte goditur nga lokomotiva me 16 vagonë të mallrave, e si pasojë e këtij aksidenti vetura e paditësit është shkatërruar plotësisht dhe e njëjta është bërë e pa përdorshme. Fakti se aksidenti ka ndodhur vërtetohet edhe nga raporti i policisë si dhe raporti i hetuesit, nr. 2011-AR-0628, i datës 15.06.2011.

Lidhur me këtë çështje është nxjerrë edhe ekspertiza e komunikacionit nga e cila ka rezultuar se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur si pasojë e kontributit të të dy palëve ndërgjyqëse, kjo pasi që paditësi ka lëvizur në rrugë lokale dhe kur ka arritur tek udhëkryqi me hekurudhën ka filluar ti kaloj binarët hekurudhor, ashtu që përkundër kushteve të mira të dukshmërisë dhe klimatike nuk e ka perceptuar apo e ka neglizhuar rrezikun dhe treni e ka ndeshur automjetin duke u shkaktuar dëme të mëdha, ndërsa përgjegjësia e të paditurës vjen për faktin se në vendet kur hekurudha depërton në rrugë lokale, organet komunale janë të obliguara të vendosin sinjalizimin adekuat, e që në rastin konkret Komuna me mos vendosjen e shenjave apo mos mirëmbajtjen e tyre ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit me lëshimet mos vendosje e sinjalizimit adekuat në rrugë lokale që kalon mbi hekurudhë.

Ndërsa lidhur me konstatimin dhe vlerësimin e dëmit është nxjerrë ekspertiza e makinerisë nga e cila rezulton se dëmi i shkaktuar në veturën e paditësit si rezultat i aksidentit është në shumë prej 6,950.00 euro.

Gjykata e Apelit, ekspertizën e komunikacionit dhe atë të makinerisë i pranon në tërësi ashtu sikurse Gjykata e shkallës së parë, duke i vlerësuar të njëjtat si profesionale, objektive dhe në përputhje edhe me provat e tjera që gjenden në shkresat e lëndës, e që pas vlerësimit të gjithmbarshëm të tyre qojnë në konstatimin dhe përfundimin se drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe drejtë është vendosur kur Gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Si rezultat i vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale pasi që Gjykata e shkallës së parë me përpikëri iu është përmbajtur dispozitave të ligjit material, pra Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve si dhe Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, duke i interpretuar dispozitat ligjore që gjejnë mbështetje në bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit.

Neni 154 i LMD-së përcakton se: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.”*, neni 155 i LMD-së përcakton se: *“Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshem) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhimbjes ose të frikës fizike apo psiqike (demi jomaterial).”*, neni 158 i LMD-së përcakton se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”*, ndërsa neni 178 përcakton se: *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesiseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë. Në qoftë se ekziston faji dypalësh, secili zotëruar përgjigjet për dëmin total që e kanë pësuar ata përpjestimisht me shkallën e fajësisë së tyre.”*

Neni 2 paragrafi 2.3 i Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor përcakton se: *“2.3. Kuvendet Komunale dhe Shërbimi Policor i Kosovës janë autoritet për të mbikëqyrë*

*administrimin e komunikacionit rrugor në rrugët publike lokale në kuadër të kompetencave të tyre.*”, neni 25.1 i LSKRR përcakton se: “25.1. Në pjesën e rrugës para vendkalimit të rrugës rrafsh në nivel me vijën hekurudhore duhet të vendosen shenjat përkatëse të komunikacionit.”, neni 154.1 i po këtij ligji përcakton se: “154.1. Shoferi i mjetit, gjatë afrimit të kalimit hekurudhor dhe gjatë kalimit të saj duhet të ushtroj kujdes të shtuar. Para se të kalojë mbi binarë, shoferi i mjetit duhet të sigurohet që mjet i cili lëvizë nëpër binar nuk është në ardhje dhe të ndërmer masa të veçanta të nevojshme, veçanërisht nëse pashmëria është e zvogëluar për shkak të kushteve atmosferike ose rrethanave tjera në rrugë.”, ndërsa neni 155 përcakton se: “155.1. Në kalimin e rrugës nëpër vijën hekurudhore pa mekanizma mbrojtës dhe për dhënien e sinjaleve me të cilat paralajmërohet afrimi i trenit, shoferi obligohet më parë të sigurohet se nëpër vijën hekurudhore nuk vjen ndonjë mjet, para se të kalojë nëpër vijën hekurudhore.” Duke pasur parasysh këto dispozita ligjore, Gjykata e Apelit vie në përfundim se marrë për bazë edhe gjendjen faktike të vërtetuar kërkesëpadia e paditësit është dashur që të aprovohet për faktin se dëmi veçse është shkaktuar pavarësisht se edhe paditësi ka pasur kontribut në shkaktimin e këtij aksidenti.

E paditura ka pasur për obligim që të vendosë shenjën e komunikacionit që paralajmëron kalimin e trenit, ndërsa paditësi është dashur që të ketë kujdes kur ka kaluar nëpër binarët e hekurudhës, andaj përgjegjësia ndërmjet tyre është e barabartë pasi që secili me lëshimet e tyre kanë dhënë kontributin e tyre në shkaktimin e aksidentit.

Po ashtu lidhur me lartësinë, Gjykata e Apelit vlerëson se shuma është adekuate me dëmin e shkaktuar kjo edhe duke u bazuar në ekspertizën e makinerisë dhe lartësinë e kontributit të paditësit prej 50%.

Në raport me kumatën vendimi është në përputhje të plotë me ligjin si në aspektin e lartësisë e po ashtu edhe kohës së llogaritjes për secilën kategori të dëmit pasi që për dëmin material koha e llogaritjes fillon nga data e parashtrimit të padisë, ashtu siç ka vendosur Gjykata e shkallës së parë.

Shpenzimet e procedurës janë vendosur konform dispozitave nga neni 452 dhe 463 të LPK-së, ku lartësia e shpenzimeve është në përputhje me shpenzimet e krijuara dhe tarifat përkatëse për këto shpenzime, andaj drejtë ka vendosur gjykata e shkallës së parë në raport me këto shpenzime.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe nuk kanë ndikim për vendimmarrje ndryshe nga ai sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.3655/2021, me datë 26.01.2024

Kryetare e kolegjit  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.